



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 283/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Muhamet Rexha, anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e Organizatës jo qeveritare (OJQ) “VEPRO DREJT” me seli në Malishevë, paraqitur kundër Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) në Malishevë, për shkak përcaktimit jo të drejt të anëtarëve nëpër vendvotimeve (VV), në seancën e panelit të mbajtur me 24.11.2010, mori këtë:

V E N D I M

PZAP shpallet jokompetent.
Hidhet poshtë ankesa si e palejuar

A R S Y E T I M I

Organizata jo Qeveritare (OJQ) “VEPRO DREJT” me seli në Malishevë, ka parashtruar një ankesë më të cilën pretendon se Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) në Malishevë, ka bërë shkelje të rëndë ligjore në përcaktimin e anëtarëve të vendvotimeve ngase organizata “VEPRO DREJT” i ka dërguar në KKZ 13 (trembëdhjetë) anëtarë që të jenë komisionarë në Zgjedhjet e 12 dhjetorit, vetëm njëri prej tyre është pranuar.

F A K T E T

Parashtruesi i ankesës pretendon se KKZ-ja në Malishevë, ka bërë shkelje të rëndë në përcaktimin e komisionarëve në Malishevë për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare sepse përfaqësimi i komisioneve nuk është bërë në mënyrë të barabartë më organizatat që kanë aplikuar. Sipas parashtruesit të ankesës anëtarët e kësaj organizate i kanë plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara nga KKZ-ja, në Malishevë, në ankesë po ashtu theksohet se KKZ në Malishevë, nuk ka vepruar njëjtë edhe me organizatat tjera lokale ngase: Organizata “Kryqi i Kuq” i ka dërguar në KKZ 29 anëtarë dhe janë pranuar 27 prej tyre, OJQ “Veteranët e Luftës UÇK - së” i ka dërguar në KKZ 19 anëtarë dhe janë pranuar 17 prej tyre dhe OJQ “Handy Kos” i ka dërguar në KKZ 19 anëtarë dhe janë pranuar 17 prej tyre. Parashtruesi i ankesës potencon se në krahasim me organizata tjera lokale në Malishevë është bërë shkelje e rëndë në inkorporimin e OJQ-ve në procesin e zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore për rastin konkret.

ANALIZË

Juridiksioni i PZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP*, Ligji Nr.03/L – 256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L- 073 dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës Ligji Nr. 03/L- 072*.

Neni 122. 1 i LZP-së:

Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të mëposhtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja, mund të apelojë atë vendim në PZAP:

- a) përfshirjen ose largimin e një personi për të marrë pjesë në programin votues brenda dhe jashtë Kosovës;*
- b) certifikimin ose kundërshtimin për të certifikuar një subjekt politik ose kandidat për të marrë pjesë në zgjedhje;*
- c) kandidatin i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;*
- d) akreditimin ose refuzimin për akreditim të një vëzhguesi zgjedhor;*
- e) vendosjen e një gjobe administrative ndaj një subjekti politik sipas nenit 42 të këtij ligji;*
- f) refuzimin për të regjistruar një parti politike brenda Zyrës.*

Pretendimet e parashtruara nga ankuesi nuk janë nën juridiksionin e PZAP-it, ngase në PZAP mund të ankimohen vetëm vendimet e KQZ-së. Më asnjë dispozitë të LZP-së e as më ndonjë dispozitë tjetër nuk është parashikuar mundësia e ushtrimit të ankesës në PZAP, kundër vendimit të KKZ.

Meqë kundër vendimit të KKZ nuk është e lejuar të ushtrohet ankesë në PZAP, e në përputhje me dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 283/2010 më datën 24.11.2010.

